

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Mafia shqiptare 15 vite aktivitet kriminal në Amerikën Latine/ Mediat ekuadoriane: Si tentakulat e tyre de përtuan në Polici, Burgje dhe Shëndetësi
ADRESA	https://dosja.al/aktualitet/mafia-shqiptare-15-vite-aktivitet-inal-ne-ekuator-historia-dhe-te-1516643
BURIMI	dosja.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	29 shtator 2026, 08:44:30 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	29 shtator 2026, 08:17:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	fa05863db1fb73e1ea755e9db0467b32de03b9a6d3baf4e05f0de7db81ff541c
TEKSTI	eba406c3235783996f17d6fe50b5d1171bfe887633ddb33eebf11416acb7dade
PAMJA	b467fbda2afae8e06261e07ed161e8ce2b8902655718c47392e5df7b5009614b

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e42de82abe7fd79ef2594c291a654bb8ccdc6cc8db09650306ab4d82a726c5df
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	5542c6f376d7530e05241a95b291e64e02f5f89d799222f37a26423635f8fe31
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahajo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e42de82abe7fd79ef2594c291a654bb8ccdc6cc8db09650306ab4d82a726c5df>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



LIVE UPDATES ▾

14 ORE ME PARE

121 ditë revoltë kundër Edi Ramës/
Protestuesit mesazh kryeministrit me
pankarta: Asgjë s'të ndal për të vjedhur, por
SPAK-u ka për ta mbledhur

14 ORE ME PARE

Debate për territorialen te "Ligjet"/
Rrëzohet kërkesa e opozitës për futjen e
draftit të saj në rend dite! Manja: Nuk e
kam në tryezë, duhet të ndjekë procedurën

20 ORE ME PARE

Pagat e magistratëve/ GJL dhe shoqatat e
gjyqtarëve nuk marrin pjesë në tryezën e
Ramës. Kryeministria: Do vazhdojmë
punën për ligjin e pagave

22 ORE ME PARE

Konferenca Ndërparlamentare/ Schieder
tregon detyrat: Kapitujt duhen
mbyllur. Rama: Europa mos të na lërë në
balltë, do jetë dështim

Aktualitet

Mafia shqiptare 15 vite aktivitet kriminal në Amerikën Latine/ Mediat ekuadoriane: Si tentakulat e tyre depërtuan në Polici, Burgje dhe Shëndetësi

Sipas ECUAVISAs, një nga figurat kryesore ishte Dritan Rexhepi, i cili u vendos në Guajakil në vitin 2011 dhe dyshohet se organizoi trafikun e kokainës drejt Evropës. Pas tij, rrjetin dyshohet se e drejtoi Dritan Gjika, ndaj të cilit në Ekuador ka hetime për krim të organizuar dhe pastrim parash.



29 Shtator 2026, 10:17
Nga E. D



EKUADOR- Mediat ekuadoriane i kanë kushuar një artikull grupeve shqiptare të drogës, duke theksuar se ato veprojnë prej më shumë se 15 vitesh. Në artikull, ECUAVISAs thekson se mafiat shqiptare kanë ndërtuar rrjete trafiku droge, kompani fiktive dhe lidhje me grupe kriminale lokale e zyrtarë shtetërorë.

Sipas ECUAVISAs, një nga figurat kryesore ishte Dritan Rexhepi, i cili u vendos në Guajakil në vitin 2011 dhe dyshohet se organizoi trafikun e kokainës drejt Evropës. Pas tij, rrjetin dyshohet se e drejtoi Dritan Gjika, ndaj të cilit në Ekuador ka hetime për krim të organizuar dhe pastrim parash.

Në artikull thuhet gjithashtu se hetimet kanë zbuluar lidhje të dyshuara me Policinë, Forcat e Armatosura, Doganat, sistemin e burgjeve dhe së fundmi sektorin shëndetësor. Më 21 shtator 2026, tetë persona u ndaluan në kuadër të hetimeve për certifikata mjekësore që dyshohet se ndihmuan Rexhepin.

Në aktivitetet e këtij rrjeti përmendet edhe shqiptari Arbër Çekaj, ndërsa disa shqiptarë, kosovarë, malazezë dhe serbë të lidhur me botën kriminale janë vrarë në Ekuador që prej vitit 2017. ECUAVISAs thotë ndër të tjera se autoritetet po vijnë hetimet për të zbardhur shtrirjen e plotë të rrjetit dhe lidhjet e tij me institucionet dhe grupet kriminale lokale.

Artikulli i ECUAVISAs:

Mafia shqiptare ka më shumë se 15 vjet që është vendosur në Ekuador. Sipas të dhënave policore dhe gjyqësore, anëtarët e këtij rrjeti të trafikut të drogës filluan aktivitetet e tyre që nga viti 2011, duke krijuar kompani fiktive,

editoriale

Meri Lika

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Enton Abilekaj

Labirinti i errët i Edi Ramës

Në vëmendje

BOTA 29 SHTATOR 2026, 09:50

Në ditët e fundit të afatit, ish-marinisi amerikan kërkon vëllanë në një kamp refugjatësh afganë në Katar

AKTUALITET 29 SHTATOR 2026, 07:51

Eksperti i sigurisë kibernetike: Hakerat e "Homeland Justice" publikojnë numrat e agjentëve të SHISH

ndonje me banda kriminale lokale dhe duke shpirtre tentakulat e tyre ne insulucione publike si Policia, Forcat e Armatosura, Doganat, SNAI (sistemi i burgjeve dhe qendrave të riedukimit), ndër të tjera, për të transportuar tonelata droge drejt Evropës.

Më 21 shtator 2026, u bënë të njohura lidhjet e mafias shqiptare me sistemin shëndetësor. Tetë persona, mes tyre ish-mjekë publikë dhe një zyrtar i SNAI-t, u ndaluan nga autoritetet, pasi dyshohet se i kishin dhënë ndihmë shqiptarit Dritan Rexhepi përmes certifikatave dhe kishin krijuar përshtypjen sikur kreu i mafies vazhonte të ishte në Ekuador.

Rexhepi, i kapur në Turqi në vitin 2023 dhe i ekstraduar një vit më parë në Shqipëri, ishte një nga shqiptarët e parë që krijoi lidhje dhe një perandori të trafikut të drogës. Pasuesi i tij ishte Dritan Gjika, i arrestuar në Emiratet e Bashkuara Arabe në vitin 2025 dhe ndaj të cilit në Ekuador janë dy hetime penale për pastrim parash dhe krim të organizuar.

Rrjeti shqiptar dhe ballkanik ka pasur edhe anëtarë të tjerë të njohur në vend, të cilët janë bërë publikë përmes hetimeve ose vrasjeve që nga viti 2017, në qendra tregtare apo komplekse banimi private. ECUAVISA mbledhi të dhënat se si u shtrinë tentakulat e mafies shqiptare.

Dritan Rexhepi, një nga bosët kryesorë shqiptarë në Ekuador

Prania e mafies shqiptare në Ekuador mori hov që nga viti 2011, me mbërritjen e Dritan Rexhepit. Ai u arratis nga autoritetet shqiptare dhe italiane dhe kërkoi strehim në këtë vend.

Anëtar i kartelit Kompania Bello, ai u vendos në Guajakil nën maskën e një biznesmeni, pasi ishte arratisur nga një burg në Belgjikë. Fliste mirë spanjisht dhe italisht, ndaj e kishte më të lehtë të komunikonte.

Kështu veproi në anonimat për tre vjet. Ai ndërtoi një sistem të sofistikuar logjistik, duke rekrutuar punonjës portualë, persona në kompanitë e transportit detar, agjentë doganorë dhe policë, gjë që mundësoi akses të sigurt në kontejnerët që dërgoheshin drejt Evropës, sipas një hetimi të portalit Código Vidrio.

Por në vitin 2014, Rexhepi u arrestua së bashku me anëtarë të organizatës së tij dhe u akuzua për trafik droge. Shqiptari përdorte edhe dy identitete të tjera në vend, njëri prej tyre Lulzim Murataj. Më pas, ai u dënua me 13 vjet burg.

Fillimisht qëndroi në burgun e Guajakilit dhe më pas u transferua në burgun Rajonal të Kotopaksit. Në atë burg krijoi miqësi me Jorge Zambranon, i njohur me nofkën Rasquiña dhe kreu i Los Choneros. Pavarësisht se ishte në burg, ai vazhdoi biznesin e paligjshëm të trafikut të drogës.

Në vitin 2021, qeveria e Italisë filloi procedurën për ekstradimin e tij, diçka që Rexhepi dëshironte ta shmangte. Po atë vit, pasi kishte vuajtur pak më shumë se 67% të dënimit, kërkoi arrest shtëpie. Ai pretendoi se vuante nga sëmundje si lupusi dhe probleme kardiake. Disa muaj më vonë përfitoi nga lirimi i parakohshëm, i cili konsistonte në paraqitje periodike dhe ndalimin e largimit nga vendi.

Rexhepi po i zbatonte këto masa deri në nëntor 2021, kur filloi të paraqiste certifikata mjekësore për të justifikuar mungesat e tij. Pesë vjet më vonë, autoritetet deklaruan se këto dokumente ishin të falsifikuara dhe pjesë e një skeme brenda sistemit publik shëndetësor.

Specialistët e përmendur nga autoritetet ende nuk janë proceduar penalisht. Njëri prej tyre publikoi një video ku siguroi se nuk kishte firmosur kurrë një certifikatë të shqiptarit, gjë që rezultoi në dokumentet e shqyrtuara nga Ecuavisa.com, dhe se ishte vetëm i ndaluar për të dhënë deklaratë. Ky rast ndodhet në fazën e hetimit paraprak.

Para Rexhepit, Arbër Çekaj

Para Rexhepit në Ekuador, shqiptari Arbër Çekaj merrej me trafikun e drogës. Ai mbërriti në vend në vitin 2009, sipas një raporti të Plan V.

Në vend, në vitin 2012, ai themeloi një kompani falë një kredie bankare dhe filloi të dërgonte banane në Shqipëri. Vetëm brenda një viti, ai dërgoi 1.000 tonë nga ky produkt.

Midis viteve 2009 dhe 2015, ai hyri në Ekuador të paktën 10 herë dhe, ashtu si Rexhepi, kishte tre numra pasaportash. Sipas hetimeve, ai dërgoi banane me 18 kompani të vendit, tre prej të cilave kishin precedentë për zbulime droge.

Anonimati i tij përfundoi në vitin 2015, kur u përpoq të përdorte një fermë për të paketuar drogë në kuti bananesh dhe punonjësit telefonuan Policinë.

Çekaj nuk u arrestua në Ekuador, pasi u arratis nga vendi pesë ditë para se të akuzohej penalisht. Në vitin 2018 u procedua në Shqipëri, ku policia gjeti 613 kilogramë kokainë në një nga ngarkesat e tij.

AKTUALITET 29 SHTATOR 2026, 07:41

VIDEO/ Personi më i moshuar i botës banon në Shqipëri, nënë Marra ka lindur 117 vjet e 39 ditë më parë

më të klikuarat

Hakerat iraniane nxjerrin mbi 600 numra të personelit të SHISH-it, publikojnë edhe dokumente konfidenciale

VIDEO/ Ambrozia Meta pyet Ramën për Ergys Agasin, kryeministri largohet me shpejtësi pas gardës

Opinion kundër mbi një konferencë pa pyetje

Të mërkurën Von der Leyen viziton Ballkanin Perëndimor/ POLITICO: BE plan të posaçëm anëtarësimi për Shqipërinë dhe tre vendet kandidatë

insights

Bledian Koka
Pse Rama i denoncoi shqiptarët si antisemitë në OKB

Besmir Semanaj
Kur të bie Diella në kokë

Rezarta Gaganj
Përballë pallatit tim po ndërtohet një pallat

Auron Janku
Kur PARTITË harrojnë pse ekzistojnë

Moti

Powered by  tomorrow.

Gjika, pasuesi i Rexhepit, pastroi më shumë se 40 milionë USD

Me rënien e Rexhepit në Ekuador, në skenën kriminale u shfaq një tjetër shqiptar: Dritan Gjika. Edhe ai u vendos në vend duke përfutur nga lehtësitë migratore, siç është shtetësia universale, dhe u paraqit si biznesmen.

Gjika krijoi rreth dhjetë kompani të lidhura me ndërtimin, eksportin e bananeve, bujqësinë, ndër të tjera. Katër prej kompanive vazhdonin të ishin aktive deri në vitin 2024, megjithëse tashmë kishte hetime në zhvillim, siç ishte rasti Pampa kundër shqiptarit.

Prokuroria akuzoi se rrjeti i Gjikës pastroi 31 milionë USD midis viteve 2015 dhe 2024, vit kur iu kontrollua banesa në një zonë ekskluzive të Samborondón. Sipas hetimeve të Policisë, Gjika ishte në krye të të gjithë procesit të trafikut të drogës, që nga miratimi i porosive për kokainë në laboratorët e Kolumbisë, deri te përfundimi i shitjeve në Evropë dhe gjurmimi i mënyrës se si pastroheshin paratë përmes blerjes së pronave, automjeteve etj.

Struktura e shqiptarit bashkëpunonte me gueriljen e FARC-ut dhe me Los Choneros, për të përcaktuar rrugët nëpër të cilat transportohej droga drejt porteve. Kokaina, njësoj siç vepronin Rexhepi dhe Çekaj, fshihej në kuti bananesh me destinacion Spanjën, Belgjikën, Holandën, Turqinë dhe Shqipërinë.

Për t'iu shmangur kontrolleve, ata kishin informacion të privilegjuar mbi dokumentet detare të tregtisë së jashtme, gjë që lehtësonte kontaminimin e disa kontejnerëve në javë. Gjika u akuzua në Ekuador për krim të organizuar dhe pastrim parash.

Ai është në statusin e të arratisurit dhe gjyket kundër tij do të aktivizohen kur të ekstradohet në Ekuador. Ndaj tij kishte dy njoftime të kuqe të Interpolit, një në Ekuador dhe një në Spanjë. Aktualisht, ai mbahet i arrestuar në Abu Dhabi që nga qershori i vitit 2025.

Infiltrimi i mafias shqiptare në Polici, Forcat e Armatosura, SNAI dhe institucione të tjera

Dosjet kundër shqiptarëve Rexhepi dhe Gjika nxorën në pah lidhjet e mafias me pjesëtarë të forcave publike dhe institucione si SNAI ose Shëndetësia. Përveç kësaj, ajo ishte e përfshirë edhe në qarqe biznesi.

Një oficer i Policisë i tha ECUAVISA se, nën maskën e tregtarëve, shqiptarët filluan të krijonin marrëdhënie me biznesmenë, ushtarakë, politikanë, policë, prokurorë, gjyqtarë dhe persona me ndikim në Ekuador. Në aspektin sentimental, ata kërkonin si të dashura kandidatet për kurorat e konkurseve të bukurisë.

Përveç kësaj, ata u bënë donatorë të disa institucioneve. Sponsorizonin kampionate voleybolli, futbollit dhe aktivitete lokale, për t'u bërë pjesë e komunitetit si "biznesmenë të bananeve". Pasi fituan fuqi ekonomike, sipas oficerit, shqiptarët investuan në ferma karkalecash dhe kompani të tjera. Për t'u fshehur, filluan të përdornin persona të tjerë si pronarë formalë.

Ndër shembujt e infiltrimit të mafias shqiptare në institucione të ndryshme është rasti i 21 shtatorit 2026, i cili zbuloi rrjetin e mjekëve që dyshohet se favorizuan Rexhepin.

Një tjetër rast ishte në vitin 2024, kur Forcat e Armatosura sekuestruan 22 tonë kokainë në një fermë në Los Ríos, me vlerë 660 milionë USD.

Prokuroria zbuloi se mafia shqiptare u përpoq të korruptonte agjentë të inteligjencës, duke u ofruar shokëve të tyre 100.000 USD për të mësuar se kush kishte zbuluar vendndodhjen e ngarkesës.

Kësaj i shtohet edhe një rrjet trafikimi karburantesh i drejtuar nga pjesëtarë të Policisë, të cilët korruptonin uniformat e kësaj strukture dhe ushtarakë, në mënyrë që të mund të nxirnin karburant nga poliduktet. Ata paguanin nga 1.000 deri në 2.000 USD për informacion mbi kontrollet, operacionet dhe për të shoqëruar kamionët me benzinë të vjedhur.

Në vitin 2017, kur u vra shqiptari Ilir Hidri, Prokuroria kontrollloi telefonin e tij. Në pajisje kishte biseda me persona që dyshoheshin se ishin pjesëtarë të Policisë Kombëtare, të cilëve u kërkonin informacion për një agjent të caktuar.

Mafia shqiptare – në ato vite – kërkonte kontakte në Njësinë e Porteve dhe Aeroporteve (UIPA), Antinarkotikët dhe madje edhe Dinased.

Gjashtë shqiptarë, serbë dhe malazezë të vrarë në Ekuador që nga viti 2017

Mafia shqiptare vepron me shtetas kosovarë dhe malazezë, të cilët gjithashtu kanë mbërritur në Ekuador në raste të ndryshme. Sipas hetimeve të kryera nga Prokuroria dhe Policia, një nga partnerët kryesorë të Gjikës ishte kosvari Remzi Azemi.

I huaji u përmend si i dyshuar për vrasjen e një shqiptari dhe të një malazezi, të ndodhura përkatësisht në vitet

2017 dhe 2018. Azemi u procedua për vrasje në vitin 2019, por u dërgua vetëm në gjyq, pasi në Ekuador nuk mundi të arrestohej.

Ai u akuzua për vrasjen e një malazezi, Fadil Kacanici, dhe bashkëshortes së tij ekuadoriane në rrugën drejt bregdetit. Të dy u rrëmbyen nga shtëpia e tyre në Guajakil gjatë një operacioni të rremë policor dhe u gjetën të ekzekutuar në anë të rrugës.

Mes shqiptarëve të tjerë të vrarë është Ilir Hidri, në vitin 2017, në jugperëndim të Guajakilit, i cili ishte ortak i Azemit. Në vitin 2020 u vranë Adriatik Tresa, brenda shtëpisë së saj në Samborondón, dhe Sasha Spasiç, në një qendër tregtare.

Në vitet 2022 dhe 2023, dy shqiptarë të tjerë vdiqën pasi u qëlluan me armë. Një nga rastet ndodhi në një restorant dhe tjetri jashtë një spitali në Guajakil.

Prokurori César Peña hetoi disa prej këtyre vrasjeve, si atë të Ilir Hidrit dhe të malazezit. Ai deklaroi se mafia shqiptare kryen krimet kryesisht për larje hesapesh.

Përveç shqiptarëve të përmendur më sipër, pjesëtarë të tjerë të këtij rrjeti të trafikut të drogës janë arrestuar në operacione të përbashkëta, por në vende si Spanja. Deri tani, autoritetet nuk kanë bërë publike figura të tjera të këtij klani në vend.

Kreu i fundit i mafias i lidhur me këtë rrjet dhe i bërë publik është serbi Jezdmir Srdan, i cili ndodhet në burgun El Encuentro./Dosja.al

dritan rexhepi mafia shqiptare

Sondazh

Poll

Aktualitet
29 Shtator 2026, 10:04

VIDEO/ Lëvizi me makinë mbi trotuar dhe publikoi videon në TikTok, gjobitet shoferi në Berat, i hiqet leja e qarkullimit

Pamje BERAT- Një qytetar në Berat është ndëshkuar me një gjobë prej 60 mijë lekësh dhe i është hequr...

Identifikohen dy persona të zhdukur gjatë luftës në Kosovë

Aktualitet
29 Shtator 2026, 10:13

EMRI/ I dënuar për vrasje me
paramendim, kapet në Bolzano të Italisë
28- vjeçari, pritet ekstradimi drejt
Shqipërisë

Aktualitet

29 Shtator 2026, 09:57

Greqia planifikon "qendra kthimesh" në
Afrikë për migrantët hisedime edhe me

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.